

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Re & Alb” shpk

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, vendosëm hartimin e këtij Statuti , me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

KREU I

Themelimi , Emri , Objekti, Kohëzgjatja , Selia

Neni 1

Data e themelimit, emri, themeluesit

Sot më datë **04/03/2024** Themelohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, person juridik, subjekt i të drejtës shqiptare me emrin **“Re & Alb” sh.p.k.**, (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Re & Alb” sh.p.k.** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga shtetasi: **Adi Zenelaj**, i cili pergjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare vetëm për kapitalin themeltar të vendosur.

Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

Shoqëria Tregtare **“Re & Alb” sh.p.k.**, e ka selinë në qytetin Vlores, Lagja "Jalli", Rruga "Tirana", Objekti nr.67 .

Posta Elektronike: re.albshpk@gmail.com

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Operator turistik detar me anije turistike, mjete turistike, operator turistik, turizem detar, familjar, udherrefyes turistik .
- Hoteleri, restorante, bar-kafe, agjensi turistike, menaxhim turizmi.
- Lavanteri dhe shërbime pastrimi
- Lavazho , etj.

Kompania mund të zgjeroj objektin e veprimtarisë në gjithçka parashikon ligji shqiptar.

Neni 4
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues me vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë që përbën 100% të kapitalit dhe ndahet në një kuotë.

- 1. Ortaku themelues; Adi Zenelaj** Zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 100 000 (Njëqind mijë) LEKË që përbën **100 % të Kapitalit themeltar të Shoqërisë.** Kontributi i Ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (Pasuri të Luajtshme/te paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:


- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar të ortakëve **lejohet** vetëm brenda ortakëve të shoqërisë.

Është e ndaluar të kalohet kuota respektive e ortakëve të persona të tretë.

Transferimi i kuotave të të tretët do të lejohet, vetëm me miratimin me shkrim nga të gjithë ortakët që zotërojnë 100 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë **“Re & Alb”** shpk.

Në çdo rast, Transferimi i kuotave bëhet me kontratë me shkrim.



Ortaku që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i Shoqërisë

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme;

- a. Përcaktimin e politikave të shoqërisë;
- b. Ndryshimet e statutit;
- c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç. Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- e. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- f. Miratimin e paqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së asamblesë
- l. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës Elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakortë për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me shumicë të thjeshtë 50+1% përqind të votave

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendos për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marr vendime të vlefshme vetëm nëse oratkët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës kuorumi të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve


1. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të thjeshtë 50+1% përqind të votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshim të statutit, zmadhim ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e Fitimeve, riorganizim dhe prishjen e Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave (50+1%) të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si;
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Administrator i shoqërisë caktohet **Z. Adi Zenelaj**, i biri i **Mejdin** i datëlindjes **29.03.1978** lindur në Vllahinë Alb, dhe banues në Lgji "29 Nentori", Rruga "Lef Sallata" Vlore, posedues i leternjoftimit me nr **033676248** dhe nr. Personal **NID H80329099F**

Administratori emerohet me afat 5 (pese) vjecar 04/03/2025-03/03/2030, me të drejtë ripërtëritje dhe shkarkohet me vendim të Asambles së Ortakëve. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit në QKB.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Organi Administrativ (Administratori) ka fuqi në menaxhimin e rregullt të Shoqërisë.

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të :

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgoje të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakëve të shoqërisë dhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe;
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë pasuri, që ka vlerë më të lartë se **5 për qind** të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të Huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si: Të Lidh Kontrata shitje-blerje, dhenie me qera, revokime, sipërmarrje të ndryshme, shkëmbimi dhe cdo lloj kontrate që parashikon legjislacioni shqiptar; huaje, deklarata të kryej veprime të ndryshme Bankare, Doganore, tregtare e financiare, të punësoj dhe të pushoj nga puna, personelin që do të zgjidhet nga ai. Të realizoj çdo veprimtari tjetër kontraktore ose jashtë kontraktore që është në interes të Shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori mund të emëroj përfaqësues të Posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

-Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse, vepron në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “.

Kreu IV

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, mbeten dhe kalojnë në pronësi, të ortakëve të shoqërisë.

Neni 18

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve .

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Punësimet në Shoqëri

Për punonjësit që do të punësohen marrëdhëniet juridike midis Shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së Punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

1. Shoqëria merr përsipër të derdh rregullisht të gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet për Sigurimin e të Punësuarve të saj në organet kompetente përkatëse në përputhje me dispozitat Ligjore në fuqi.

Kreu V

Prishja -Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 20

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakëve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të

Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët e shoqërisë marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tyre emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ *Shoqëri ne Likuidim e Sipër* “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët e Shoqërisë.

Nëse Ortakët e shoqërisë nuk marrin vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi- ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901 datë 14-04-2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër të posaçëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues të shoqërisë.

Ky Statut është hartuar sot më datë 04/03/2025.

PËR SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Re & Alb” sh.p.k

ORTAKËT:

Adi Zenelaj

Adi Zenelaj
[Signature]